

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 13.12.2021, duke shqyrtuar mbi iniciativën e parashtruar nga avokatja Snezhana Stankoviç nga Shkupi 03Su.nr.262/21 të datës 29.03.2021, sipas nenit 101 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të nenit 37 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 58/2006...96/2019), miratoi:

MENDIM JURIDIK PARIMOR

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë me të cilin është vërtetuar aktvendimi i noterit si përfaqësues të gjykatës lejohet ankesë.

A r s y e t i m

Sipas nenit 128 të Ligjit për procedurë jashtëkontestimore (“Gazeta zyrtare e RM” numër 9 të datës 18.01.2008), “Kundërshtimin jo në kohë, jo të plotë ose kundërshtimin e palejuar, gjyqi do ta hedh poshtë. Duke vendosur për kundërshtimin kundër aktvendimit që e ka miratuar noteri, gjyqi në tërësi ose pjesërisht aktvendimin do ta vërtetojë ose ta anulojë. Kur gjyqi aktvendimin pjesërisht do ta anulojë ose pjesërisht do ta vërtetojë, vetë do të vendosë për pjesën e anuluar të aktvendimit. Kundër aktvendimit të gjykatës me të cilin aktvendimi i noterit në tërësi ose pjesërisht është anuluar, lejohet ankesë në afat prej 8 ditësh nga dorëzimi i aktvendimit të shkallës së parë. Aktvendimi pas kundërshtimit u dorëzohet pjesëmarrësve dhe noterit. Ndaj aktvendimit të noterit kundër të cilit është deklaruar kundërshtimi, ndërsa gjyqi e ka hedhur poshtë, klauzolën për plotfuqishmëri e vendos gjyqi që vendos për kundërshtimin. Aktvendimi i noterit kundër të cilit nuk është deklaruar kundërshtim është i plotfuqishëm. Klauzolën për plotfuqishmërinë e këtij aktvendimi e vë noteri. Gabimet në emrat dhe numrat, si dhe gabimet tjera të dukshme në shënimin, do t’i përmirësojë ai që e ka miratuar aktvendimin. Përmirësimet do të kryhen me aktvendim të veçantë, ndërsa pjesëmarrësve do t’u dorëzohet aktvendim i posaçëm.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore del se kundër aktvendimit të Gjykatës me të cilin aktvendimi i noterit është vërtetuar, nuk është shënuar nëse lejohet ose nuk lejohet ankesë.

Megjithatë, me atë që nuk është shënuar e drejta e deklarimit të ankesës nuk do të thotë se kundër një aktvendimi të tillë nuk lejohet ankesë.

Kjo për arsye se, sipas nenit 33 paragrafi 1 të Ligjit për procedurë jashtëkontestimore, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, në procedurën jashtëkontestimore në mënyrë përkatëse do të zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë kontestimore.

Sipas nenit 368 paragrafi 1 të Ligjit për procedurë kontestimore ("Gazeta zyrtare e RM" numër 79/2005...124/2015), "Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë lejohet ankesë, nëse me këtë ligj nuk është caktuar se ankesë nuk është e lejuar".

Sipas nenit 15 paragrafi 1 me amendamentin XXI nga Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë, me të cilën zëvendësohet neni 15 i Kushtetutës garantohej e drejta e ankesës kundër vendimeve të miratuara në procedurën e shkallës së parë në gjykatë.

Nga e ekspozuara, pa diskutim del se kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, me të cilin vërtetohet aktvendimi i noterit si përfaqësues i Gjykatës lejohet ankesë, për atë arsye Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut e konstatoi, përkatësisht e miratoi këtë mendim juridik parimor.

Gjykata Supreme e
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Seanca e përgjithshme